

UDHËZIM
Nr.9, datë 25.6.2007

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 30.1.2006
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, pas pikës 9.2, shtohet pika 9.2.1 “Libri i çmimeve të shitjes”, me përmbajtje si më poshtë:

“9.2.1 Libri i çmimeve të shitjes

Libri i çmimeve të shitjes është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe përmbajtja e tij është sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Të gjitha faqet e librit duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo muaj. Në këtë libër regjistrohen çmimet e shitjes me shumicë dhe me pakicë, përfshirë TVSH-në, të aplikuara nga personi i tatueshëm për periudhën e muajit raportues.

Çmimet e deklaruara të shumicës, janë ato që janë aplikuar nga personi për furnizime të realizuara në drejtim të personave të tjerë të regjistruar në TVSH ose në biznesin e vogël.

Çmimet e deklaruara me pakicë, janë ato që janë aplikuar për konsumatorët finalë, në shitjet e kryera në vendet e veçanta të deklaruara nga personi i tatueshëm për shitjet me pakicë.

Personat e tatueshëm të cilët kanë në nomenklaturën e mallrave të furnizuara deri në 20 artikuj, janë të detyruar të deklarojnë çmimet me shumicë dhe pakicë për të gjithë artikujt e nomenklaturës.

Personat e tatueshëm, të cilët kanë më tepër se 20 artikuj të destinuara për shitje janë të detyruar të deklarojnë në librin e çmimeve të shitjes, 20 artikujt të cilët përbëjnë volumn më të madh të shitjeve të tyre.

Personat e tatueshëm të cilët furnizojnë shërbime, gjithashtu janë të detyruar të deklarojnë në këtë libër çmimet e aplikuara për shërbimet e furnizuara gjatë muajit.

Shembull:

Personi i tatueshëm x, furnizon shërbime të suvatimit në procesin e ndërtimit. Ky person detyrohet të deklarojë çmimin për njësi (m²) të këtij shërbimi.

Një kopje e librit të çmimeve të shitjes paraqitet në degën e tatimeve brenda datës 14 të çdo muaji.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

LIBRI I ÇMIMEVE TË SHITJES

muajin.....Vitin.....

Çmimet e shitjes për

[illegible]

Administratori
Emër mbiemër:

Vula

Ky libër, plotësohet në dy kopje dhe njëra dorëzohet në degën e tatimeve brenda datës 14 të muajit pasardhës.